

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË TATIMEVE BERAT

Raporti përfundimtar i auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore, Berat “Mbi zbatimin e legjislacionit tatimor në procesin e realizimit të të ardhurave tatimore, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore si dhe vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm” për periudhën 2013-2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 61, datë 30.06.2015.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, me shkresat nr. 180/16 dhe nr. 180/15, datë 06.07.2015, për znj. Brisida Shehaj me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Tatimeve dhe z. Guximtar Gojka me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, i janë dërguar “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i dokumentacionit të Raporteve të Kontrollit rezultoi se në lidhje me zërin “*Kapitali aksioner*” të deklaruar nga subjektet, rezultojnë shumë herë më të vogla se “*Aktivet Afatgjata*” gjë e cila tregon se nuk është bërë “*Kapitalizimi nga ortakët i kontributit të tyre*” veprime këto: jo në përputhje me kërkesat e nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “*Për qendrën kombëtare të regjistrimit*” dhe jo në përputhje me kërkesat e nenit 177 dhe 178 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*”, cila ka efektin te origjina e kapitaleve si dhe te llogaritja e amortizimit. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 69-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, DRT Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me zërin “*Kapitali aksioner*” të deklaruar nga subjektet për të gjitha rastet që rezultojnë shumë herë më të vogla se “*Aktivet Afatgjata*”, të bëjë Kapitalizimin nga ortakët i kontributit të tyre, duke nxjerrë përgjegjësitë dhe personat përgjegjës me qëllim që të mos përsëritet fenomeni në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2015

2. Nga auditimi i dokumentacionit rezultuan se nga DRT. Berat janë bërë në total 37 zhbllokime të llogarive të subjekteve debitorë veprime jo në përputhje me: kërkesat e nenit 77.5; nenit 78.1; nenit 92.1/2; nenit 102 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “*Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar dhe kërkesat e pikave 77-77.2, pika 78, pika 92-92.1.1, pikën 102-102.1.1, shkronjat a, b, c, ç të Udhëzimit nr. 24, datë 02.9.2008 të MF “*Për procedurat tatimore në republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 90-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, DRT Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me zhbllokimet e llogarive të subjekteve debitorë të nxjerrë përgjegjësitë dhe personat përgjegjës me qëllim që të mos përsëritet fenomeni në të ardhmen.

Brenda datës 31.12.2015

3. Nga auditimi rezulton një mungesë e theksuar e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të brendshme të saj, kryesisht Drejtorisë së Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit me Drejtorinë e Kontrollit Tatimor, si dhe ndërmjet sektorëve të Regjistrimit, të Vlerësimit, të Kontrollit, të Verifikimit në Terren, të Mbledhjes së Borxhit dhe Zyrës së teknologjisë Informacionit përpunimit fiskal dhe statistikës, veprime këto që bien ndesh me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore pjesa e II-të, pika 27, Drejtoritë Rajonale Tatimore. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa të plota lidhur me organizimin dhe funksionimin bashkëpunues midis Drejtorive dhe Sektorëve në përbërje të saj, me qëllim rritjen e nivelit të të ardhurave nga çdo tatim dhe taksë e programuar, nëpërmjet realizimit eficient të detyrave nga secili punonjës i stafit.

Në vijimësi

4. Nga auditimi rezulton se nuk janë penalizuar subjektet të cilët nuk kanë paraqitur informacionet e duhura për zbatim e udhëzimeve vjetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me dorëzimin e pasqyrave financiare të subjekteve, miratimi i tyre dhe respektimi i afateve ligjore, veprim që bie ndesh me kërkesat e nenit 126 "Mosdhënia e informacionit" të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në RSH". *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë i është rekomanduar Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat, që të mos pranojë asnjë pasqyrë financiare të paraqitur nga subjektet tatimpagues, pa një kontroll të plotë formal të saktësuar në një procesverbal unik, ku të regjistrohen të gjitha mangësitë e konstatuara nga verifikim i kryer nga inspektori i vlerësimit

Menjëherë

5. Nga auditimi për vlerësimin e veprimtarisë së DRT mbi llogaritjen dhe pagesën e tatimit në burim rezulton se Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit nuk ka kërkuar nga subjektet që kanë ushtruar veprimtari ekonomike në objekte apo terrene të kontraktuar me qera, një kopje të kontratave të lidhura me qeradhënësit që të dorëzohet për administrim në Sektorin e Vlerësimit Tatimor, duke krijuar kështu mundësi reale për evazion fiskal nga mosvjelja e tatimit në burim, veprim që bie ndesh me kërkesat e nenit 33 germa "ë", "Mbajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa konkrete për të saktësuar nëpërmjet Sektorit të Verifikimit në Terren të gjithë subjektet që kryejnë aktivitetin e tyre ekonomik në ambiente apo godina të kontraktuara me qira, një kopje e së cilës duhet të administrohet në mënyrë të detyrueshme nga Sektori i Vlerësimit Tatimor.

Menjëherë

6. Nga auditimi i procedurave të ndjekura për gjendjen e tatimpaguesve deklarues, mosdeklarues dhe deklarues me pagesë zero për TVSH-në dhe analiza mbi ecurinë e këtyre treguesve nga një periudhë ushtrimore në tjetrën në vlerë dhe sipas subjekteve u konstatua se, DRT nuk paraqiti një raport-analizë për masat e marra lidhur me verifikimin dhe më pas kontrollin e situatave faktike të deklaruara nga subjektet tatimpaguese me tepricë kreditore të tatimit mbi vlerën e shtuar, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qëndrore nr. 8608 prot, datë 04.10.2010, miratuar nga Ministri i Financave, pjesa II, Drejtoritë Rajonale Tatimore. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, me grupe pune të posaçme të analizojë nga zyra në mënyrë formale sipas një programi pune të veçantë të miratuar, ato subjekte tatimpaguese që rezultojnë me teprica kreditore apo me humbje, të cilat më pas të kalojnë për kontroll të plotë të thelluar nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit në Drejtorinë e Kontrollit të Tatimor.

Në vijimësi

7. Nga auditimi rezulton se Regjistrat e Rimbursimit të tepricës kreditore të TVSH-së nuk janë të formatizuar (unik), me numër fletësh të inventarizuara dhe të sekretuara, por një bllok i vizuar, ku kriteret e vendosura (miratuara) për regjistrimin e të dhënave dokumentare që kanë paraqitur tatimpaguesit përkatës, nuk janë pasqyruar në regjistër, por ato janë shënuar me shkrim dore nga punonjësit që kanë administruar regjistrat, veprime këto që bien ndesh me kërkesat e udhëzimit nr.

17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa konkrete për të përgatitur Regjistra Rimbursimi (unik), për regjistrimin e kërkesave të paraqitura nga subjektet tatimpaguese për rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së.

Në vijimësi

8. Nga auditimi rezultoi se Drejtoria Rajonale Tatimore Berat nuk i ka zbatuar rast pas rasti masat shtrënguese të përcaktuara në ligjin nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 88-101, si dhe kërkesat Rregullores së Brendshme të Administratës Tatimore Qendrore nr. 8608, datë 04.10.2010, të Miratuar nga Ministri i Financave, për arkëtimin e borxhit tatimor **në vlerë 1,338,206 mijë lekë**, sipas afateve ligjore të përcaktuara në legjislacionin tatimor. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 72-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, të marrë masa të plota në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Zyrën e Përmbarimit Gjyqësor, në mënyrë që të zbatohen në kohë dhe me efektivitet masat shtrënguese për arkëtimin e borxhit tatimor të pa paguar

Në vijimësi

9. Nga auditimi i dokumentacionit dhe ballafaqimi, rezultoi se nga Sektori i Kontrollit në Terren nuk janë kryer procedurat e verifikimit të subjekteve që edhe pse deklarojnë xhiro kanë kasë zero si dhe edhe pse të regjistruar në QKR rezultojnë të papajisur me kasë fiskale, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit: 122 gërma “b”; 122 gërma “a” të ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore Në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar si dhe jo në përputhje me kërkesat e nenit 27 dhe nenit 31.2 të Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot. datë 04.10.2010 lidhur përkatësisht me detyrat funksionale të: Drejtorit të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe detyrat e Sektorit të Verifikimit në Terren. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa të plota, për verifikimin e subjekteve që edhe pse deklarojnë xhiro në pasqyrat financiare lidhur me aktivitetin tregtar, rezultojnë të mos kenë prerë kupona tatimor nëpërmjet kasës fiskale si edhe për subjektet e regjistruar në QKR që ushtrojnë aktivitet tregtar por që rezultojnë të papajisur me kasë fiskale, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë në lidhje me personat përgjegjës sipas aneksit nr. 12; nr. 13 dhe nr. 14 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

10. Nga auditimi i dokumentacionit dhe ballafaqimi, rezultoi se nga kontrolli i ushtruar për subjektin [REDAKTUAR] rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar për të cilin observacioni dhe dokumentacioni i pamjaftueshëm bashkëlidhur, e bëjnë të vështirë arritjen e një vlerësimi të saktë të ngjarjeve ekonomike në këtë kompani. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 30-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për arritjen e një vlerësimi të saktë të ngjarjeve ekonomike në këtë kompani, të marrë masa të plota për të kryer një rikontroll i plotë në këtë subjekt për periudhën në fjalë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nisur nga gjetjet të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandojmë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, marrjen në shqyrtim të këtyre gjetjeve të konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pa përllogaritura dhe të pakontabilizuara, të cilat në total janë në vlerën **63,601,460 lekë**, për praktikat e mëposhtme:

B.1. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje penalitetet e vendosura si pasojë e shkeljeve të ndryshme në fushën tatimore për subjekte me fushë veprimi në territorin e kësaj drejtorie, por të rregjistruara në drejtori të tjera tatimore, janë penalizuar nga kjo drejtori për shkelje të ndryshme tatimore të cilat i janë përcjellë drejtorive përkatëse tatimore në rrugë zyrtare. Nga verifikimi i tyre në sistemin elektronik të të dhënave C@TS si dhe nga ballafaqimi, rezultuan veprime jo në përputhje me kërkesat e nenit 29.1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Tiranë dhe Fier, të marrë në shqyrtim gjetjet e konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pakontabilizuara, për **39 raste**, në vlerën **3,600,000 lekë**, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë në lidhje me personat përgjegjës sipas aneksit nr. 10 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

B.2. Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat të merren në shqyrtim gjetjet e konstatuara në lidhje me detyrimet tatimore të pa përllogaritura dhe të pakontabilizuara, të cilat në total janë në vlerën **60,001,460 lekë** në mënyrë analitike si më poshtë:

B.2.1. Nga auditimi i Raporteve të Kontrollit dhe dokumentacionit bashkëlidhur tyre, rezultuan fshehje dhe shmangie nga pagimi i detyrimeve, veprime këto jo në përputhje me: kërkesat e neneve 116; 124; 115; 118; 128.1 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar dhe nenit 124.1 të Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 të Ministrisë të Financave; kërkesat e nenit 12/3 “Shpenzime të panjohura” të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, gërma “I”; kërkesat e nenit 33 të ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, pika 19 ku është përcaktuar hollësisht mënyra e llogaritjes së kreditimit të pjesshëm. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 25-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **43 raste**, në vlerën **45,142,131 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

B.2.2. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Drejtoria e Vlerësimit të të Ardhurave Tatimore dhe Kontabilitetit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultuan shkelje të procedurave si dhe fshehje dhe shmangie nga pagimi i detyrimeve, veprime këto jo në përputhje me: kërkesat e neneve 126; 116.1 dhe 117 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar dhe neneve 30.5 dhe 33.1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 16-25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe

procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **805 raste**, në vlerën **8,523,173 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 1; nr. 2; nr. 3; nr. 4; nr. 5; nr. 6 dhe nr.7 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

B.2.3. Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga Sektori i Kontrollit në Terren dhe dokumentacionit, rezultuan penalitete të pakontabilizuara si dhe vendosje penaltetesh jo në përputhje me kërkesat e nenit 29.1; 40.1 dhe 122.1/(iii) të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 71-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **39 raste**, në vlerën **955,000 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 9 dhe nr.11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

B.2.4. Nga auditimi i procedurave të ndjekura në marrëdhëniet e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat me Degën e Thesarit dhe nga ballafaqimi, rezultuan fshehje dhe shmangie nga pagimi i detyrimeve, veprime këto, jo në përputhje me kërkesat e nenit 116.1 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 76-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit për **18 raste**, në vlerën **5,131,156 lekë** nga subjektet sipas aneksit nr. 15; nr. 16 dhe nr.17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda datës 30.09.2015

B.2.5. Nga auditimi i procedurave të ndjekura në marrëdhëniet e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat me Inspektoriatin Shtetëror të Punës, rezultoi punëmarrës i pasiguruar dhe nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat nuk është penalizuar subjekti punëdhënës, veprim ky, jo në përputhje me kërkesat e nenit 119 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 81-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar që, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat të marrë masa për kontabilizimin dhe zbatimin në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit nga subjekti .[REDAKTUAR] në vlerën **250,000 lekë**.

Brenda datës 30.09.2015

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Tatimeve që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të konsideruara nga ana jonë si shkelje shumë të rënda, të urdhërojnë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave përkatëse, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013:

Neni 58 gërma “ç”, “largim nga shërbimi civil” për 2 nëpunësit civil, si më poshtë:

1. Për [REDAKTUAR] me detyrë ish-Drejtores e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, aktualisht me detyrë specialiste pranë zyrës së agjencisë së shërbimit të tatimpaguesve Kuçovë, për veprimet jo në përputhje me:

- kërkesat e nenit 18.1, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar;
- kërkesat e nenit 5.1/2 të Udhëzimit nr. 16, datë 16.2. 2009 të MF “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”; pasi për subjekte të cilët kanë deklaruar vlera monetare shumë të mëdha në zërin “Hua” dhe “Marrëdhënie me Ortakun” nuk ka kryer analizën dhe verifikimin e burimit të këtyre vlerave monetare.
- kërkesat e nenit 77.5; nenit 78.1; nenit 92.1/2; nenit 102 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- kërkesat e pikave 77-77.2, pika 78, pika 92-92.1.1, pikën 102-102.1.1, shkronjat a, b, c, ç të Udhëzimit nr. 24, datë 02.9.2008 të MF “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar; pasi ka kryer zhbllokimin e llogarive bankare për subjektet debitorë
- kapitullin II, neni 27 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 në përmbushje të detyrave funksionale dhe kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; pasi kanë miratuar, evaduar dhe vlerësuar Raporte Kontrolli të cilat kanë rezultuar me shkelje të kërkesave të këtij ligji, në total për **37 (tridhjetë e shtatë) raste**.

Trajtuar hollësisht në faqet 25-72; 82-89; dhe 90-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Për [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, për veprimet jo në përputhje me:

- kërkesat e nenit 18.1, të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar;
- kërkesat e nenit 5.1/2 të Udhëzimit nr. 16, datë 16.2. 2009 të MF “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”; pasi për subjekte të cilët kanë deklaruar vlera monetare shumë të mëdha në zërin “Hua” dhe “Marrëdhënie me Ortakun” nuk ka kryer analizën dhe verifikimin e burimit të këtyre vlerave monetare.
- kërkesat e nenit 77.5; nenit 78.1; nenit 92.1/2; nenit 102 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- kërkesat e pikave 77-77.2, pika 78, pika 92-92.1.1, pikën 102-102.1.1, shkronjat a, b, c, ç të Udhëzimit nr. 24, datë 02.9.2008 të MF “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar; pasi ka kryer zhbllokimin e llogarive bankare për subjektet debitorë
- kapitullin II, neni 27 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 në përmbushje të detyrave funksionale dhe kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; pasi kanë miratuar, evaduar dhe vlerësuar Raporte Kontrolli të cilat kanë rezultuar me shkelje të kërkesave të këtij ligji, në total për **53 (pesëdhjetë e tre) raste**.

Trajtuar hollësisht në faqet 25-72; 82-89; dhe 90-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimi).

C.2. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të fillojë procedurat përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 nga “vërejtje” deri “largim nga shërbimi civil” për 6 nëpunësit civil:

1. [REDAKTUAR]; 2. [REDAKTUAR]; 3. [REDAKTUAR]; 4. [REDAKTUAR]; 5. [REDAKTUAR]; 6. [REDAKTUAR], me detyrë Inspektor Kontrolli në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat;

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 31.1 të të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 për mospërmbushje të detyrave funksionale, konkretisht:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit;
 - jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, cila ka efektin te origjina e kapitaleve si dhe te llogaritja e amortizimit;
 - jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar;
 - jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
 - jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
 - jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH”, pika 19;
 - jo në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 të Ministrit të Financave;
- Trajtuar hollësisht në faqet 25-71 dhe 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

C.3. Mbështetur në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtores së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat që në vlerësim të shkeljeve të mëposhtme sipas pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të fillojë procedurat përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore, sipas nenit 59.2 të ligjit nr. 152/2013 nga **“vërejtje” deri “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”** për 5 nëpunësit civil:

1. ■■■■■; 2. ■■■■■; 3. ■■■■■; 4. ■■■■■; 5. ■■■■■ me detyrë Inspektor Vlerësimi në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat,

Për shkeljet e konstatuara në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara në nenin 29.1 të të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nr. 8608 prot, datë 04.10.2010 për mospërmbushje të detyrave funksionale, konkretisht për veprimet:

- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- jo në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Trajtuar hollësisht në faqet 16-25 dhe 76-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për përgjegjësitë mbi të metat dhe mangësitë e konstatuara, të trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nuk rekomandohet masë për 3 ish- punonjës, pasi janë të larguar nga sistemi tatimor.

D. MASA PËR BASHKËPUNIM INSTITUCIONAL

1. Nga auditimi i Raporteve të Kontrollit Tatimor të DRT, Berat, rezultoi se nga subjektet e biznesit janë mobilizuar fonde nga individë të ndryshëm për qëllim të biznesit në formë huaje pa vërtetuar prejardhjen e tyre, burimin e krijimit dhe mënyrën e marrjes pasi nuk kanë kaluar fondet nëpërmjet sistemit bankar apo nëpërmjet kontratave ligjore të huamarrjes dhe kreditimit. Ky fenomen është konstatuar dhe nga auditimi i brendshëm i DPT i cili i ka kërkuar nëpërmjet rekomandimeve DPT dhe DRT Berat marrjen e masave për të kërkuar nga subjektet dokumente që vërtetojnë burimin e fondeve të marra në formë huaje. DPT dhe DRT Berat nuk kanë marrë masa të mëtejshme në vlerësim të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm, për rikontroll dhe investigim të mëtejshëm të këtyre rasteve si dhe nuk kanë adresuar problemin tek institucionet e ngarkuar me ligj si Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave në bazë të kërkesave të nenit 18.1 të Ligjit nr.

9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar dhe kërkesave të nenit 5.1/2 të Udhëzimit nr.16, datë 16.02.2009 të Ministrisë së Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, duke krijuar në këtë mënyrë, me veprime e mosveprime, mundësinë që individë të ndryshëm të përdorin subjektet e biznesit për të futur në rrugën e legalizimit fonde më burime të paligjshme të krijimit me qëllim pastrimin e tyre.

Trajtuar më hollësisht në faqet nr. 66-69 dhe 82-89 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për këtë është rekomanduar që, DRT Berat, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të marrë masa për instalimin e komunikimit institucional, duke ndjekur rrugët ligjore të bashkëveprimit dhe bashkëpunimit për adresimin e problemit të huave të marra nga bizneset jo në përputhje me kriteret ligjore dhe financiare tek Drejtoria e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave me qëllim që të ndiqen në rrugë ligjore individët që tentojnë të shfrytëzojnë subjektet e biznesit për pastrimin e parave duke shmangur prejardhjen dhe burimin e krijimit të tyre, si dhe të instalohen mekanizma të kontrollit paraprak të deklarimeve të subjekteve në raport me mobilizimin e fondeve për qëllim të biznesit në formë huaje, për të parandaluar marrjen e huave nga subjektet e biznesit në kundërshtim me kriteret ligjore dhe kërkesat e administrimit dhe raportimit financiar.

Brenda datës 31.12.2015

E. KALLZIM PENAL

Për të gjitha shkeljet e konstatuara, në drejtim të moskryerjes siç duhet të kontrollove dhe kontrollove tatimore, miratimit në bilancet e subjekteve të shumave të konsiderueshme të deklaruara si të marra hua pa kryer asnjë analizë apo verifikim në lidhje me rregullshmërinë apo vërtetësinë e këtyre shumave, mosdeklarimit pranë organeve përkatëse në lidhje me këto shuma për të cilat ngrihen dyshime të arsyeshme të kryerjes së aktiviteteve në drejtim të pastrimit të parave, si dhe favorizimin e subjekteve të ndryshme përsa i përket zhbllokimit të llogarive bankare të bllokuara më parë nga DRTB, KLSH ka depozituar pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Berat, kallëzimin penal nr. 180/17, datë 16.07.2015, ndaj:

- 1. z. G.G.,** me detyrë funksionale Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve;
 - 2. znj. M. D.,** me detyrë funksionale ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve;
 - 3. z. T. M.,** me detyrë funksionale ish-Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve;
- të cilët në mospërmbyllje të rregullt të detyrës së tyre funksionale kanë konsumuar elementët e figurës së veprave penale të “**Shpërdorimit të detyrës**” dhe “**Moskryerjes së detyrave nga organet tatimore**” parashikuar nga nenet 248 dhe 181/a të Kodit Penal.

Trajtuar hollësisht në faqet 66-69; 82-89 dhe 90-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Shënim: Auditimi u krye përgjatë periudhës 10.03.2015 deri më 22.05.2015, nga audituesit Agron Opari, përgjegjës grupi, Livan Hoxha, Hekuran Avdulaj, Anesti Gjika dhe Dorino Meçe, anëtarë, u mbikëqyr nga Kryeauditues z. Albert Thoma, më tej u shqyrtua nga Drejtori i Departamentit zj. Albana Agolli dhe Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

DRT Berat nuk ka kthyer ende përgjigje për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve pasi është brenda afatit ligjor për kthimin e përgjigjes.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT